

VENDIM
Nr.19 datë 1.2.1999

PËR DISA MASA PËR PLOTËSIMIN MË MIRË TË NEVOJAVE PËR BANIM

Për të shpejtuar plotësimin e nevojave për banim, në zbatim të detyrave të plenumit të 9-të të Komitetit Qendror të PPSH, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në qytete dhe në fshatra e qendra të tjera të banuara të NB-ve të ndërtohen banesa të reja vetjake nga shtetasit, veç e veç ose me marrëveshje edhe në grupe, me shpenzimet e vetë shtetasve dhe me kredi bankare.

2. Në qytete, ndërtimi i banesave vetjake të bëhet nga shtetasit, nga ndërmarrjet e sistemit të ndërtimit ose edhe nga ndërmarrje të tjera që kanë veprimtari ndërtimi. Vlerësimi i punimeve të bëhet sipas çmimeve të manualeve të Ministrisë së Ndërtimit. Për ndërtimin e banesave vetjake, ndërmarrjet lidhin kontratë me shtetasit, ku përcaktohen detyrimet e ndërsjella.

3. Në NB-të të fuqizohen brigadat ose sektorët e ndërtimit dhe, sipas nevojave e kërkesave të shtetasve, të marrin pjesë në ndërtimin e banesave vetjake.

Materialet e ndërtimit të sigurohen nga shtimi i prodhimit të tyre në NB-të, nga vetë shtetasit dhe nëpërmjet ndërmarrjeve tregtare, sidomos hekuri, çimentoja etj.

4. Ministria e Ndërtimit dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të marrin masa me organet e tyre projektuese për hartimin e projekteve të banesave, duke pasur parasysh kërkesat e shtetasve në përputhje me rregullat e urbanistikës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI